

SUELA ARMATA (CENOLLI)
SHITËSJA E ËMBËLSIRAVE
ROMAN

BOTIMET TOENA

SUELA ARMATA (CENOLLI)

SHITËSJA E ËMBËLSIRAVE

roman

BOTIMET TOENA

Tiranë

Botuese: Irena Toçi

Kryeredaktore: Edona Marku Huqi

Redaktor letrar: Eris Rusi

Përkujdesja grafike dhe kopertina: Elsa Hajderaj

ISBN 9789928817020

©Autorja

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Nuk lejohet shumëfishimi me asnjë lloj mjete apo forme, as me fotokopje, pa lejen me shkrim të mbajtësit të copyright-it.

BOTIMET TOENA

Rr. "M. Gjollësja", K. Postare 1420, Tiranë

Tel.: + 355 4 22 40 116

Email: botimet.toena@gmail.com

toena.porosionline@gmail.com

<https://toena.al>

Parathënie

Nga dr. Eris Rusi

Momenti mistik, kur ulesh dhe vendos të krijosh një botë të tërë që buron brenda teje. Mendimet, ndjesitë, përfytyrimi i ngjarjeve që pritet të marrin jetë dhe që akoma nuk kanë shenja të dallueshme e të pavarura nga njëra-tjetra, qëndrojnë të gjitha në mendjen tënde. Krijuesi që rri në heshtje, të dëgjojë si mbushen me frymë personazhet e krijuara prej tij. Ky tis magjie dhe idili që lidhet me krijimin letrar, ka ushqyer prej shekujsh imagjinatën e shkrimtarëve, të lexuesve, të atyre që te letërsia kanë mundur të gjejnë koordinatat e ekzistencës, e që edhe sot vazhdojnë të ruajnë të njëjtin pasion.

Te kjo frymë, në pasionin e shkrimit, shkrimtarja Suela Armata gjen mundësinë t'i japë vetes lirinë krijuese. Në romanin e saj të parë “Shitësja e ëmbëlsirave”, ajo ndërton një botë që merr nga përditshmëria dhe pasurohet me teknikat e rrëfimit letrar. Çfarë është një botë letrare që ka për hapësirë të sajën një horizont që është sa faqet e një libri? A ka

më vend për letërsinë në një bashkëkohësi ku magneti mbi kryet e njerëzve nuk ngjit mbi të padukshmen (shpirtëroren, mistiken e ekzistencës), por mbi të vërtetdukshmen (shëmbëllimin e rremë, fasadën që i kërkon gjërat në sipërfaqe), pa kërkuar të shkojë më tej?

Autorja ngjan t'i japë përgjigje këtyre dilemave me zgjedhjen për të shkruar një roman ku ndihet nevoja e saj për t'u kujdesur në çdo detaj të tekstit. Personazhet vijnë nga bota reale dhe marrin ngjyrë, dritë-hije, tingëllojnë sipas kornizës që letërsia vendos mbi rrugëtimin e tyre. Shkrimtarja, në këtë paradoks, nuk përngjan me shkrimtarët që ndihen të rrezikuar nga mënyra si shihet dhe interpretohet letërsia në bashkëkohësi. Ndërkohë që shumë krijues mundohen të krijojnë një shteg të tyrin, kur një pjesë prej tyre provojnë të imitojnë shtigje të rrahura nga të tjerë, Suela Armata ka në qendër të vëmendjes lexuesit, edhe ata që janë të shpërndarë e të humbur në drejtime të ndryshme, edhe në kushtet kur sa vjen e bëhet më i vështirë profesioni i shkrimtarit. “Ajo çka mund të bësh ti, është veç një pikë në oqean, por kjo pikë i jep kuptim jetës sate”, shprehet shkrimtari amerikan E. L. Doctorou, e ndoshta te ky qëndrim qëndron forca e autores për t'i dhënë lexuesit një botë të tërë nën titullin “Shitësja e ëmbëlsirave”: një libër që nuk është shkruar nën jehonën pompoze të tambureve, por që prek në thelb jetën dhe të papriturat që ajo ruan për çdonjërin prej nesh. Edhe mënyra si ftohet lexuesi

që të bëjë për vete këtë libër, është sa e thjeshtë po aq edhe tunduese: Në një nga rrugët kryesore të qytetit gjendet një dyqan ëmbëlsirash ku të rastis të kalosh çdo ditë. Nuk je futur asnjëherë brenda, por prej së largu dallon trajtat e një vajze, e cila ngjan me ëndrrën, buzëqesh dhe mirësia shkëputet si dritë prej saj. Është Ilda, protagonistja e romanit që të bën t'i jepesh leximit të librit dhe të depërtosh në historitë e vogla njerëzore ku kryqëzohen lumturia dhe trishtimi i jetës.

Pas krijimit të lidhjes mes librit dhe lexuesit, krijohet mundësia që ky i fundit të eksplorojë jetën si një rrugëtim i pandërprerë mes emocioneve të ndryshme si lumturia, trishtimi dhe fataliteti. Ekzistenca shoqërohet me një lëvizje të vazhdueshme të ndjenjave, shpeshherë të papritura dhe të thella, e atëherë kur ngjan e vështirë të besohet tek e mira, njeriu mund të gjejë ekuilibrin që e vendos në harmoni me veten dhe me botën që e rrethon.

E njihni dhe ju shitësen e ëmbëlsirave?

E njihni dhe ju vajzën e ëmbël që ka shenjat e humbjes tragjike të prindërve në aksident?

E njihni dhe ju Ildën në lulëzimin e moshës së saj, kur i dorëzohet dashurisë së parë, kur bie pre e një dashurie fatkeqe, kur qan e vuan nga dhuna e burrit, kur shtypet e brengoset nga tradhtitë dhe poshtërsitë e tij?

Ilda i ngjan një fytyre të njohur, një njeriu që na ka lënë përshtypje me jetën dhe peripecitë e kaluara

në të. Ajo është një grua që përballon fatkeqësi të shumta, me një ekzistencë që nis me qetësinë e një deti në gjumë, por që më pas mbulohet nga dallgët e fatit që dinë të jenë të pamëshirshme dhe fatkeqe.

Mëngjes. Bashkë me frymëmarrjen e botës që nisi të mbushte rrugët e qytetit, rrezet e diellit depërtuan dhe filluan të ndriçonin perdet e holla në dhomën e Ildës. Gjithçka po rikthehej në realitet nga drita që nisi të ledhatonte objektet njëra pas tjetrës. Edhe heshtja ishte e përkohshme. Në ajër u fashit një tingull i thatë, zilja e telefonit, që la gjurmë në ajër. Ilda lëvizi në shtrat, i hapi sytë dhe për një moment vrojtoi e hutuar telefonin e vendosur në tavolinën e vogël të natës, një aparat modern brenda asaj shtëpie ku koha ngjante e ngrirë prej vitesh. Duke u ngritur me ngadalë, Ilda kaloi duart mbi fytyrë për të fshirë lodhjen e natës së kohëve të fundit. Përbrenda i regëtiu mendimi që do të dëgjonte zërin e shpresës përmes telefonit.

Ky fragment, të lejon të kuptosh pak mbi natyrën e tekstit: një rrëfim mes ëndrrës dhe reales, ku përditshmëria nuk mund të bishtnohet asnjëherë. Autorja zgjedh që të trajtojë subjektin duke ndjekur dy linja paralele: ngjarjet që trajtohen në ditët e sotme dhe kujtimet e Ildës, bota e së kaluarës ku ajo ka përjetuar dashuri, dhimbje, zhgënjim. Personazhet e tjera, shërbejnë për të mbajtur në ekuilibër personalitetin e protagonistes. Vdekja e prindërve bën që Ilda të kapë për dore të vëllain dhe së bashku të dalin në udhëtimin e madh të jetës me njëri-tjetrin si mbështetje. Kjo lidhje

i mbijeton të gjitha fatkeqësive dhe është dëshmi e dashurisë së sinqertë të motrës ndaj vëllait. Më tej kemi një tjetër personazh të rëndësishëm: profesor Arturi, i cili rrëmbehet nga një pasion i paprovuar më parë ndaj Ildës, dikur studentja e tij, e për këtë ndjenjë lufton deri në kurorëzimin e plotë të ëndrrës për t'u bashkuar me Ildën përfundimisht.

Teksti, që ushqehet nga temat sociale, ngjan të jetë i çliruar nga paragjykimet dhe komentet që mund t'i bëhen sjelljeve të personazheve në libër. Gjithkush është i shënjuar nga pak mëkat e pak mirësi në jetë, e askush nuk mund të mendojë që bota është e mbushur me shenjtore që nuk guxojnë të bëjnë asnjë prapësi. Autorja i jep forcë këtij qëndrimi, nuk ndërhyr, nuk gjykon, por rrëfen dinamikat që ndjekin jetën dhe fatin e personazheve. Gjithçka ka kuptim, shumëçka merr vlerë, nëse Ilda e gjykon se kështu duhet të jetë për veten e saj. Në këtë mënyrë, lexuesi sheh të marrë formë karakteri i protagonistes: Ilda si një grua e lirë, si një grua që nuk i shpëton syrit dhe epshit të meshkujve edhe në moshë të pjekur, si një grua që nuk ka mundur t'i shpëtojë dhunës fizike dhe verbale të partnerit të saj, por që në fund kërkon lirinë, e në rrugë e sipër gjen edhe dashurinë e zemrës, që e bën të lumtur atë.

Nën këtë dritë, “Shitësja e ëmbëlsirave” mund të konsiderohet një roman që zbulon në mënyrë të prekshme dhe të thellë të gjitha ndjenjat, vuajtjet dhe gëzimet e një gruaje që përballet me jetën, duke

shfaqur fuqinë dhe këmbënguljen për të vazhduar udhëtimin, për të krijuar të nesërmen e jetës, ku emocionet dhe dashuria janë kambana që ngjall kureshtjen, që prek zemrën dhe mendjen e lexuesit në mënyrë të pashmangshme.

Përvoja e jetës trajtohet si një përzierje e këtyre emocioneve, si një rrugëtim që nuk është i thjeshtë, por që shpesh sjell mësimet më të rëndësishme dhe frymëzimin më të thellë. Njeriu është në kërkim të lumturisë, duke përballur trishtimin, dhe duke përpjekur të kuptojë nëse fati është i shkruar apo gjithçka është në duart tona. Çdo hapësirë që mbushim me përpjekjet që bëjmë, me dhimbjet, lotët, buzëqeshjen, dashurinë, formon një pjesë të jashtëzakonshme të ekzistencës së njeriut, duke e bërë atë një rrugëtim të pasur me ngjarje, mësimet dhe ndjenja që rikompozojnë dhe ngrohin shpirtin e njeriut. Këto janë koordinata për t'u bërë pjesë e përmbajtjes së librit dhe lexuesi ftohet të bëhet pjesë e një udhëtimi emocional në botën e protagonistes, Ildës, për të përjetuar emocione të forta gjatë leximit të tij.

KAPITULLI I

Mëngjes. Bashkë me frymëmarrjen e botës që nisi të mbushte rrugët e qytetit, rrezet e diellit depërtuan dhe filluan të ndriçonin perdet e holla në dhomën e Ildës. Gjithçka po rikthehej në realitet nga drita që nisi të ledhatonte objektet njëra pas tjetrës. Edhe heshtja ishte e përkohshme. Në ajër u fashit një tingull i thatë, zilja e telefonit, që la gjurmë në ajër. Ilda lëvizi në shtrat, i hapi sytë dhe për një moment vrojtoi e hutuar telefonin e vendosur në tavolinën e vogël të natës, një aparat modern brenda asaj shtëpie ku koha ngjante e ngrirë prej vitesh. Duke u ngritur me ngadalë, Ilda kaloi duart mbi fytyrë për të fshirë lodhjen e natës së kohëve të fundit. Përbrenda i regëtiu mendimi që do të dëgjonte zërin e shpresës përmes telefonit.

- Alo? Përshëndetje! - ai zë i panjohur e ktheu tensionin e saj në kureshtje.

- Përshëndetje! - u përgjigj dhe fjalët i dolën të ëmbla, ndërkohë që një buzëqeshje e lehtë i ndriçoi fytyrën.

- Me Ilda Demirin po flas? - pyeti zëri nga ana tjetër e linjës.

- Po, unë jam! - tha ajo me një ndjesi çlirimi, duke ndier shpirtin t'i drithërohej.

Dhe pastaj, u dëgjua pyetja që ngjante se do të sillte ndryshimin e shumëkërkuar në jetën e saj:

- Ju keni aplikuar për punë, në pozicionin e shitëses këtu në punishten tonë. Ju intereson akoma?

Pasi dëgjoi këto fjalë, fytyra e Ildës u mbush me një ndjenjë ngazëlluese. Një lumturi e thellë e përzier me ankthin e padurueshëm filluan të përhapeshin në të gjithë trupin e saj. Ky ishte momenti që priste prej kohësh, mundësia për të nisur përsëri të jetonte, për të ndryshuar gjërat në botën e saj.

- Po, sigurisht. Kam qenë në pritje të telefonatës suaj, - tha me zë të sigurt dhe të qetë.

- Atëherë, ejani që nesër dhe më takoni në punishte. Besoj do të kemi mundësi të punojmë së bashku. Mirupafshim!

- Mirupafshim! - u përgjigj ajo me gëzim. Pas asaj telefonate, shtrëngoi telefonin dhe u pushtua nga një emocion i fortë. Nuk mund të besonte se një telefonatë e vetme mund t'i ndryshonte aq shumë gjërat. Krejt papritur, vetja iu duk si në një roman, ku protagonistja po përjetonte një kthesë të papritur të ngjarjeve. E ndjeu veten si heroina që kapërcente pengesat dhe arriti në momentin e fitores. Gjithë ankthi që kishte ndier po tretej gradualisht dhe po zëvendësohej me një ndjenjë të re, ku ajo nuk stepej të përballëj me të papriturat e jetës. "Nuk thonë kot se Zoti kur të mbyll një derë, të ka hapur një tjetër", mendoi e bukura

grua. I shkoi të dyja duart mes për mes flokëve dhe psherëtiu e lehtësuar. Pastaj duke qeshur me zë, sikur të kishte dikë përpara, i telefonoi Ronit, të shoqit, e gjithë ankth i tregoi telefonatën.

- Akoma në një vrimë i bie fyellit ti? - i ulëriu të shoqes nga celulari. - Sa herë të kam thënë se s'kemi nevojë për lekët e tua. Nuk do të shkosh!

Ilda e mbylli bisedën dhe e flaku tutje, mbi divan, telefonin. Me mollëzat e gishtave filloi të masazhonte tëmthat e kokës që po i pulsonin rrëmbimthi. Me fjalinë e përhershme "Ehhh, po ashtu bën gjithmonë ai", u mundua të ngushëllonte veten.

Në këto sekonda tringëlliu sërish zilja e celularit. Ilda nuk kishte nevojë të lexonte emrin, për ta kuptuar kush ishte. Sapo ia hap, ai sërish ulërin si luan:

- Kujt ia mbyll telefonin ti? I ke bërë ditët ti, të ma mbyllësh mua?! Ta dish që...

Ajo nuk tha asnjë fjalë, por e mbylli sërish telefonin. Ai e telefonoi përsëri dhe ajo ia mbylli. Ai sërish e bën telefonin të ulërijë, por ajo nuk ia hapi më. E ndjeu se shtëpia do të merrte flakë së shpejti.

Mori frymë thellë dhe doli në verandë. Natyra iu afrua me gjithë bukurinë e saj. Ngrohtë dhe plot aromë lulësh, ajo verandë iu duk vendi më i qetë në ato çaste. Kishte nevojë të reflektonte. Kujtimet filluan të rrjedhin si lumë në mendjen e Ildës, shpalosur para syve të saj me ngjyra të ndezura dhe tinguj të butë. Ajo s'ish e sigurt sesi, por mëngjesi i kishte hapur derën kujtimeve të mbyllura, duke i sjellë përsëri në sipërfaqe emocionet dhe ngjarjet e harruara.

Binte në sy menjëherë për bukurinë e saj. Me shtat mesatar, ezmere, me flokë të gjatë e kaçurrelë, me sy të thellë e ngjyrë gështenje nën dy vetulla harkore. Hundëhequr e me një gojë të vogël, por me buzë të tulta e formëbukura. Në qëndrim serioz, buza e poshtme i rëndohej dhe të ndillte në kafshime, ndërsa kur qeshte shndriste vendi rreth saj nga vezullimi i dhëmbëve rruazë e të fildishtë. Një buzëqeshje që hipnotizonte këdo! Trupi i hajthëm e këmbët e plota tërhiqnin shikimin e çdo burri që i ndodhej pranë. Eleganca në ecje e në veshje nuk linte vend për sugjerime të tjera. Seç kishte dhe një shikim lozonjar, por vetëm kur donte ajo ama. Ndoshta atë i kish dhuruar nëna kur e solli në jetë, por rrugës iu lodh dhe e fshihte nga përfituesit. Bukuria, shpesh i kishte hapur probleme, e për një grua të rritur në një realitet province, nuk kishte ditë që të mos përballej me komente që e fyenin dhe e lëndonin. Por Ilda dinte të ngrohej me ëndrrat e saj. Vajzë nga fshati që studionte në qytet. Nga një familje me ekonomi jo të ngritur, ajo zhytej në libra deri në orët e vona, ose ngrihej shumë herët për të studiuar, me qëllimin e vetëm që të arrinte të bëhej dikushi në jetë. Mirëpo e keni dëgjuar kur thonë se: “kur lind një vajzë, edhe strehët e shtëpive qajnë?!” , fati nuk u soll aspak drejt me jetën e brishtë të kësaj vajze. Nga një fatkeqësi e papritur, Ildës iu mbyll brenda një dite dera e shtëpisë: prindërit i vdiqën të

dy në një aksident. Sapo zbritën nga autobusi, kur po mateshin të hynin në rrugën për në fshatin e tyre, të kapur për krahu, një makinë që doli nga muzgu i ditës u përplas me gjithë shpejtësinë mbi ta, duke i lënë të vdekur në vend. Mbetën jetimë të dy, me vëllain e saj më të vogël se vetja. E vrarë në shpirt, me zinë që i rrinte mbi kokë si një pëlhurë e zezë, Ilda vendosi të braktiste studimet. I duhej të punonte për bukën e gojës, që të ushqeheshin motër e vëlla, mbetur mes udhëkryqit. Ardi, vëllai i saj 14-vjeçar tentoi të linte shkollën edhe ai për të punuar, në mënyrë që t'i vinte në ndihmë sadopak shtëpisë. Ai e përjetonte ngarkesën e rëndë që Ilda kishte marrë në supe. Ngjarja e papritur e vdekjes së prindërve i kishte çuar ata në një rrugë të mbingarkuar me përgjegjësi të papritura.

Por Ilda e dinte se shkolla ishte pasaporta e tyre për një të ardhme më të mirë. Me çdo fjalë dhe veprim të saj, ajo dëshmonte se familja ishte më e rëndësishme se çdo gjë tjetër, dhe ajo do të bënte çdo gjë për ta mbrojtur dhe ndihmuar vëllain e saj të vogël në rrugën e arsimit. Me dashuri e me vendosmëri e bindi Ardin që të shkollohej ai i pari e pastaj ajo. Me vështirësi, por djaloshi iu bind të motrës. E donte, e adhuronte, e respektonte shumë dhe tani edhe më tepër.

Ilda përjetoi një rrugë të pasigurt dhe të mbushur me sfida për të gjetur një punë pas humbjes së rëndë të prindërve. Për një kohë të gjatë, ajo eksploroji mundësitë e ndryshme, aplikoi për shumë vende dhe u përball me refuzime të shumta. Por me ndihmën e

disa shoqeve të mira dhe të vendosura, ajo arriti të gjejë një sistemim të përshtatshëm. Do bënte dadon e një fëmije 2-vjeçar. Një vajzë bukuroshe e topolake. Çifti jetonte në qytet, ndaj Ildës i duhej të udhëtonte dy herë në ditë nga fshati në qytet e nga qyteti në fshat.

Babai i fëmijës ishte pedagog në universitet dhe Ildën e njihte mirë, ndaj i vinte keq që një vajzë si ajo i pat braktisur studimet në vitin e fundit. Bashkëshortja e tij punonte si arkitekthe në Bashkinë e qytetit. Të dy burrë e grua punonin me orë të zgjatura, gruaja më shumë, ndaj kishin nevojë për një dado. Duke qenë në dijeni të fatkeqësisë së Ildës, ata i ofruan një pagesë të mirë. Do t'ia paguanin edhe koston e rrugës për transportin e saj, meqenëse jetonte në fshat. Orari ishte i zgjatur: shtatë e tridhjetë me pesë pasdite, por për momentin, zgjedhje më të mirë jeta nuk po i ofronte.

Si bisedoi me të vëllain për punën që kishte gjetur, i dha atij disa porosi, për të mos u larguar nga shtëpia me kohë të zgjatur, të mos harronte të blinte bukë, pasi furra mbyllej derisa ajo kthehej, si dhe të mbyllte dritaret e shtëpisë menjëherë sapo të kthehej nga shkolla.

Të nesërmen, deri te qendra e fshatit, ecën bashkë. Më pas Ardi e përqafoi të motrën gjithë dashuri dhe i uroi punën e mbarë. Secili shkoi në punën e vet: ai në shkollë dhe Ilda në punë.

Gjithë pasagjerët e autobusit e shihnin me kureshtje, dikush ndoshta me admirim. Por Ilda ishte

mësuar tashmë me këtë ritual të përditshëm, që prej kohës së gjimnazit dhe nuk i bënte më përshtypje. E ç'faj kishte ajo se ishte e bukur?! Ishte e vetëdijshme për këtë gjë, por kurrë nuk e shfrytëzoi, përkundrazi...

U tregua korrekte në orar që në ditën e parë të punës. Çifti i ri e priti me ngrohtësi dhe e çmoi për korrektësinë. E prezantuan me Rinën, vogëlushen 2-vjeçare, e cila sapo kishte filluar të formonte fjalitë e para. Iu derdh Ildës në krahë duke ikur nga kraharori i së ëmës.

- Mirëmëngjesi Rinushe!

Vogëlushja bjondinë e sygjelbër buzëqeshi si e turpëruar dhe iu fut në gjoks.

- Sa e ëmbël! - komentoi Ilda.

Më pas zonja Lida i tregoi ambientin e shtëpisë, dy dhoma e kuzhinë.

- Këto ditët e para, do të mundohem të shkëputem nga pak për të të ardhur në ndihmë, derisa Rina të mësohet. Është pak grindavece, por për të ngrënë nuk të bezdis, është llupëse - e porositi Lida.

- Ndoshta vij dhe unë ndonjëherë, në ndonjë orë të lirë, - tha me zë të butë profesori dhe u largua pa humbur kohë për në punë.

- Këtu ke numrat tanë të telefonit, për çdo gjë, e di ti, - porositi zonja sërish. Ilda u ndje pak e hutuar, por pasi mblodhi veten, e siguroi gruan se çdo gjë do të shkonte mirë.

Arkitektja u largua. Ilda filloi të merrej me vajzën. Nuk vonoi dhe i hynë në zemër njëra-tjetrës. Pasi e ushqeu, e zbaviti pak me lodra dhe e vuri në gjumë.

Pastroi rrëmujën që shkaktoi vogëlushja, lau ato pak enë që u bënë pis dhe filloi të gatuate drekën e vajzës, supë me pak mish viçi dhe perime. Kishte një libër me 330 receta ushqimore, për të cilin u kujdes që ta blinte. Jo se nuk dinte të gatuate, por për siguri...

Diku rreth mesditës, ndjeu zhurmë në sallon dhe nxitoi të shihte. Befas u përball me Arturin

- Oh, profesor, po ju?! - u habit ajo.

- Mos u shqetëso Ilda! Kisha 2 orë pushim dhe erdha të shoh Rinën.

- Është mirë, mos kini merak profesor. Tani po fle si sheqerkë. Hëngri pa naze.

- Sa mirë! - e përgëzoi ai. - Qenke e zonja moj vajzë.

- Faleminderit! - belbëzoi Ilda dhe iku në kuzhinë për të vazhduar drekën e vogëlushes. Ai e ndoqi me sy. Diçka i fërgëlloi në mendje dhe tundi kokën me një shprehje dyshimi në fytyrë.

Arturi ishte 32 vjeç, shtatlartë dhe me një hijeshi që binte në sy. Flokët e qethur shkurt fare i nxirrnin në pah formën e bukur të kokës. Rreth tëmthave i ndriçonin si xixa, ca thinja, që hijeshonin më tepër pamjen e tij burrërore. Lidën ia kishin prezantuar dhe lidhja e tyre kishte qenë me mblesëri. Për fat të çuditshëm, ndonëse të dy ishin të rinj dhe me një pozitë të mirë në jetë, ata u martuan me një dashuri të kombinuar nga të tjerët. Arturi ishte një tip sportiv me një humor të lirë, dhe Lida kishte zbuluar se ajo mund të dashurohej fare lehtë pas tij. Martesa kishte

qenë ogur bekimi për të ty, por shumë shpejt jeta i pat vënë në sprovë të vështirë. Fëmija i tyre i parë, një djalë i quajtur Rinush, u largua nga jeta në mënyrë të mistershme. Për këtë humbje të dhimbshme, askush nuk mundi të gjejë një arsye të qartë, por spekulimet e fqinjëve vazhdonin. Ata mendonin se Rinushi mund të ishte mbytur nga gjiri i të ëmës, pasi atë e kishte zënë gjumi duke e mëkuar. Këtë gjë, e vërtetuan kur u lind Rinushja. Lida kishte refuzuar ta ushqente me gjë. Ndoshta e vërtetë, ndoshta thashetheme...

Duke menduar këto fjalë, të dala nga gojët e shoqeve të cilat e njihnin familjen e profesorit, Ilda shpërlau duart dhe shkoi të shihte vogëlushen, nëse ishte zgjuar apo flinte. Në dhomë kishte hyrë Arturi dhe i ulur në një cep të krevatit, i bëri me shenjë Ildës që çdo gjë ishte në rregull. Ajo mbylli lehtë derën dhe vazhdoi me sistemimin e gjërave të vogla në sallon. Më pas nuk dinte ç'të bënte. Po të hynte në dhomë, do t'i prishte rehatinë profesorit, ndaj vendosi të ujiste lulet në ballkon. U kënaq me to, pasi u mori erë të gjithave. Duke u përkëdhelur kujt petalet e kujt gjethet, afroi kokën duke u përkulur mbi një vazo plot me jaseminë. Aroma e tyre e dehte.

- Të pëlqejnë lulet? - e trembi zëri i Arturit.

- Oh, profesor, shumë! Më falni!

- Pse kërkon falje? Dhe të lutem mos më thërrisni profesor, Artur, madje Turi më thaj.

Ilda u skuq e gjitha. E kishte kapur në një pamje çlodhjeje dhe i dukej sikur kishte abuzuar me paratë e tyre.

- Po shkoj të shoh Rinën, - i tha.

- Rri edhe pak, ajo po fle.

- Atëherë po shoh supën, - gjeti justifikim vetëm për të mos ndarë të njëjtën hapësirë me të. Supën e kish mbaruar me kohë, por e trondiste prania e atij burri.

- Ah, - psherëtiu nën zë Arturi. - Ç'po më ndodh kështu?

Kishin opinion të mirë për të në universitet. Ishte serioz e nuk kishte histori me studente, si mund të flitej për një pjesë të pedagogëve. Gjatë kohës që Ilda ndiqte universitetin, atij i ndodhte shpesh ta shihte në oborr ose nëpër shkallë, duke hyrë në mësim. E mbante mend para dy vjetësh në një orë mësimore, ai duke shpjeguar leksione, sapo ndeshi me fytyrën e Ildës, e harroi thelbin e çështjes. I kujtoheshin pëshpëritjet dhe të qeshurat nën buzë të studentëve, por edhe seriozitetin e saj që ia lehtësoi ngarkesën emocionale. Që prej asaj here e përshëndeste çdo mëngjes. Ajo ia kthente me dashamirësi.

- Hiqi nga koka këto iluzione! - e sulmoi veten i kapur mat nga emocionet që provoi nga prania e Ildës pranë tij.

U dëgjuan të qarat e Rinës në dhomë dhe u përplasën të dy me Ildën në derë. Më fal njëri e më fal tjetri, askush s'po e merrte vajzën e vogël nga shtrati i saj, ku qe ngritur në këmbë e fërkonte sytë me lot. Pastaj u dëgjua një "Bum" mbi tapet. Vajza ra. Ilda nxitoi me vrap, ndërsa Arturi kishte shtangur në derë

si monument. Shihte dadon e re tek qetësonte fëmijën e tij e s'po mundej t'i afrohej dot. Befas u kujtua se duhet të largohet. E puthi nxitimthi të bijën dhe u dha këmbëve me shpejtësi.

Rina e vogël u qetësua, por në pjesën anësore të ballit, atje ku i ra pesha e trupit nga rrëzimi, iu ngrit si bri një xhungë. Ilda u mundua t'ia sheshonte me një monedhë, ashtu siç kishte parë prindërit e saj, por s'po funksiononte. Pastaj i ra ndër mend për akull dhe nxitoi për te frigoriferi. U mundua të gërryente me thonj pak akull në formë bore, por ato pak grimca i shkrinin menjëherë në dorë. Rrëmbeu nga mungesa e akullit, një pako mishi të ngrirë. E futi në një qese për siguri higjienë dhe ia vendosi vogëlushes në ballë, duke u përpjekur shumë që t'ia mbante, pasi vajza refuzonte nga të ftohtët. Pas disa orëve u qetësua krejt. Luajti e u kënaq me vajzën, derisa erdhi Arturi sërish. Ai i përshëndeti dhe u sul për tek e bija.

- Si është? - pyeti i shqetësuar.

- Më mirë, por më duket se i ka mbetur pak shenjë në ballë.

- Ku? Obobo vogëlushja ime! O zemra e babit! - dhe s'ndalonte së puthuri Rinën. Ilda po ndihej në faj. Arturi e vuri re dhe duke shkuar në sallon bashkë me të bijën u mundua ta zbuste atmosferën.

- Mos u shqetëso! Do ia them unë Lidës, nuk ishte faji i askujt.

Ora po shkonte katër e pasdites. Duhej dhe një orë pa të plotësohej orari i punës. Ilda mendoi të

sistemonte pak rrëmujën me lodrat e së voglës. Fshiu enët e lara me një pecetë të thatë e i vendosi në dollap.

- Mbeti dhe një racion supë, po e fus në frigorifer, - thirri duke menduar se Arturi ishte nga salloni.

- Dakord! - u përgjigj ai fare pranë saj, duke zgjatur dorën për të marrë një gotë ujë. Nuhaste aromën e vaniljes së parfumit të saj dhe iu duk të përhumbej në një botë tjetër me atë aromë.

Rina e vogël hallakatej nëpër dhomë me hapat e saj të vegjël e të pasigurt. Pasi vendosi tasin me supë, të mbuluar me kapak, në frigorifer, Ilda mori vogëlushen e shkoi në sallon. Mori pultin e televizorit dhe gjeti një kanal filmash vizatimorë, ku Tomi e Xherri loznin gjithë ditën. Vuri re se Rina u tërhoq pas filmit e po e ndiqte me vëmendje. Sapo shfaqej Xherri në ekran ajo qeshte me të madhe. I tërhoqi vëmendjen edhe Arturit, i cili u ul në kolltukun tjetër, e kënaqej me të qeshurat e vajzës. Herë pas here, i hidhte Ildës ca shikime, por vjedhurazi.

Gajasej Rina e vogël, qeshte e kënaqur Ilda dhe mijëra vezullime ndriçonin dhomën.

- O Zot, - mendoi Arturi, - më ruaj nga këto mendime!

Buzëqeshjet e Ildës i ngjallnin dëshirë për t'ia ngulur sytë e ta sodiste me ëndje atë bukuri që i kish ardhur në shtëpi. Buzët e saj gjithë tul e ngjyrë vishnjë i ngjallën epshin djaloshtar.

- Nuk është e drejtë, - pickoi veten ai.

Ilda ktheu kokën. Iu duk sikur i kishte folur asaj, megjithëse nuk i kishte dalluar mirë fjalët.

- Ilda, ti mund të ikësh, - i tha Arturi me frikën mos i ishte zbuluar tërheqja që po e turbullonte së brendshmi.

- Mirë, ju e dini profesor!

- Akoma profesor do të më thërrasësh?

Ajo s'foli. Mori çantën e varur në varëse, përqafoi Rinushen, përshëndeti me buzëqeshje Arturin e u largua gjithë elegancë nga shtëpia, duke e lënë atë të tronditur, në vend, me aromën e vaniljes përqark tij.

KAPITULLI II

Mëngjesin e ditës tjetër, Ilda kishte mbërritur në kohë në vendin e ri të punës. Duke ngjitur shkallët për në katin e tretë, u përball me Arturin.

- Mirëmëngjesi profesor!

-Mirëmëngjesi! Profesor?

Ilda buzëqeshi duke hedhur prapa një tufë kaçurrela. Aroma e vaniljes shpërtheu në ato çaste. Frymëmarrja e Arturit u përshpejtua, ndaj ai u mundua ta kontrollonte duke u kollitur.

- Më duhet të shkoj pak më herët sot, - i tha dhe i tregoi një dosje me dokumente, si për t'i bërë me dije se shkak u qenë ato. - Shko se Lida është brenda. Kujdes se është pak e zemëruar! - e me këto fjalë, duke vënë buzën në gaz, ai rendi nëpër shkallët poshtë.

- Pse? -pyeti Ilda edhe pse e dinte që s'do merrte përgjigje, pasi ai humbi jashtë me shpejtësi. Ngriti vetullat e hutuar dhe u ngjit lart. I ra ziles me drojë. Dera u hap.

- Mirëmëngjesi Lida!

- Ah, erdhe, mirëmëngjesi! - ia ktheu ajo pa e parë në sy e duke veshur xhaketën. Rina ndiqte lëvizjet e saj. Ilda e mori në krahë e i doli nga para të zonjës.

- Si ka qenë Rina, natën?

- Është grindur me veten. Ju pati rënë dje? Më tregoi Turi. Kishe ikur më herët. Duhet të më kishe pritur, të paktën derisa të plotësoje orarin.

- Por...

- Mos humb kohë. Të kam sjellë karota të freskëta. Shtrydhja të përziera me dardhë e mollë. Shiko ç'mund t'i sajosh diçka me qumësht dhe oriz, - e porositi e vendosur, më pas e puthi të bijën fort e doli. Por s'vonoi që dera të hapej sërish:

- Ah, se harrova, për çdo gjë më telefono!

Ilda e shtangur ishte gati t'ia plaste të qarës me të madhe.

- Paska dhe nga këto, - mendoi.

Pastaj u mundua t'i harronte, duke i thënë vetes: "Më duhet kjo punë. S'duhet të bëj naze". Fundja të drejtë kishte.

Rina, më e pafajshmja, e shihte sikur ta kuptonte që ishte mërziur, dhe e prekte në faqe me doçkat e vogla. I kish fituar zemrën Ildës, ndaj e donte praninë e saj. E nduku të voglën për faqesh e mendoi t'i vinte Tomin e Xherrin për ta parë në TV. Ndërkohë që aventurat e tyre e kënaqnin dhe e argëtonin vogëlushen, Ilda shtrydhi frutat në kuzhinë. Lau enët e bëra pis, i fshiu e i vendosi në dollap. Shkoi në sallon, pa vajzën e vogël që ende e tërhiqnin çapkënët e ekranit dhe vendosi të rehatohej bashkë me të në kolltuk. Pak më vonë e ushqe. Rina nuk kish naze në të ngrënë ndaj të kënaqte; por filloi të nervozohej e të grindej

me rrobat dhe lodrat e saj. Ilda s'po dinte t'i jepte shpjegim dhe të parën gjë që bëri, e përqafoi dhe e puthi. Faqkat e saj iu dukën të nxehta. I vuri dorën në ballë, e njëjta ndjesi.

- Po tani?! - mendoj me zë.

Nuk dinte ku kishte termometër dhe ndonjë analgjetik. Kjo gjë nuk i kishte shkuar ndër mend të zonjës së shtëpisë për t'ia shpjeguar Ildës.

Kapi telefonin e formoi numrin e Lidës. Numri që kërkoi rezultoi i paarritshëm. Pastaj formoi numrin e Arturit. Ai u përgjigj menjëherë:

- Urdhëro!

- Ilda jam profesor! Më duket se Rina ka temperaturë. Nuk po gjej termometër. Mos e dini ju vallë se ku e ka lënë zonja?

Arturit i erdhi turp që nuk mund t'ia konfirmonte dot ku ndodhej termometri, pasi me të vërtetë nuk e dinte se ku mund të ishte.

- Shko tek komshija ngjitur, Moza. Kërkoja në emrin tonë. Është grua e mirë. Më telefono sërish.

- Dakord! Po shkoj profesor! - nxitoi Ilda. Kur u kthye, ishte bashkë me Mozën dhe ajo e ndihmoi për t'ia matur temperaturën vogëlushes. Termometri shënjonte 38°.

- Duhet t'i japim gjysmën e paracetamolit, - tha Moza menjëherë.

- Nuk e di ku ka, - ia ktheu Ilda. - Sot është dita e dytë që punoj këtu dhe ende nuk e kemi prekur këtë temë.

Moza nxitoi për në shtëpinë e saj dhe erdhi shpejt me ilaçin në dorë. Ia tretën në një lugë të vogël me ujë dhe ia dhanë për të pirë vogëlushes, e cila e përskuqur flakë, mezi e gjëlltiti për shkak të hidhësisë.

- As unë nuk ia di këto gjëra moj çupë, - i tregoi Moza. - Nuk afronte njeri Lida. Thonë që është shumë xheloze. Çudi si të ka futur në shtëpi ty moj hënë! Arturi është shpirt njeriu. Zoti e faltë!

Dhe sapo përmendi emrin e Arturit, rastësia bëri që ai të telefononte për vajzën:

- Alo, Ilda, si bëre me Rinën?

- Shkova te Moza, siç më thatë profesor, mora termometrin, por m'u desh t'i kërkoja dhe paracetamol, pasi vërtet kishte temperaturë.

- Ashtu, sa i shkoi?

- 38° profesor.

- Uaa, po pse? Apo ku e di unë thuaj?!

Vetë pyeti e vetë u përgjigj Arturi nga shqetësimi.

- Nuk është as Lida, për fat të keq. Më telefonoi se do të shkonin në Tiranë, në një seminar... Më dëgjon Ilda?

- Po profesor!

- Do t'ia dalësh dot, derisa të vij unë? - e pyeti si me përgjërim.

- Do të përpiqem. Pastaj kam edhe Mozën. Është grua e mirë, ashtu siç më thatë edhe ju.

Moza buzëqeshi me atë që dëgjoji.

- Shumë mirë moj vajzë. Të falënderoj! - dhe mbylli telefonin.

Çdo 10 minuta ia matnin temperaturën Rinës së vogël. Pasi kaloi gjysmë ore, asaj filloi t'i binte gradualisht. Vetëm kur i shkoi 36,7° atëherë iku Moza. Ilda e falënderoi përzemërsisht e gjithë mirënjohje.

Vështroi orën e cila shënonte 12:00 e drekës. E ushqeu vogëlushen me pak supë e pastaj i dha racionin e milimetruar të lëngut të frutave. Kësaj here, hëngri duke u grindur, por lëngun e piu me etje. E shtriu për ta vënë në gjumë. Temperatura edhe pse i qe normalizuar, ndikonte në gjallërinë e saj dhe ajo çoroditje ia kishte kapitur muskulaturën vogëlushes, ndaj e zuri gjumi menjëherë.

Edhe Ilda ndihej e topitur për vete. Sipas rregullit, ajo nuk duhej t'i ndahej fëmijës për asnjë çast, kështu vendosi të shtrihej pak mbi krevatin e çiftit, pasi në krah të tij ndodhej krevati i vogëlushes.

“Nëse ndiej zhurmë, do të ngrihem”, mendoi ajo. Ashtu tha e ashtu bëri.

Shtëpinë e mbizotëronte qetësia e pastërtia. Jashtë kishte filluar një shi i shtruar dhe moti qe freskuar pak. Dritaret qenë pikëluar të gjitha nga shiu dhe nga brenda ishin veshur nga pak me avull.

Tik-taku i orës nuk lodhej. Ora dy e drekës dhe vajzat ende flinin. Arturi u kthye nga puna dhe u fut pa zhurmë në shtëpi. Kishte bërë pazar dhe i mbështeti me kujdes qeset mbi banakun e kuzhinës. Pa që në sallon nuk kishte njeri, ndaj hapi ngadalë derën e dhomës së gjumit.

Sytë i shkuan menjëherë tek mrekullia e tetë e botës, që shtrihej në krevatin e tij. U afrua pak e pastaj

vështroi në të djathtë, anën në të cilën ndodhej e bija. Ajo flinte e qetë. Ia vuri dorën pak tek balli, me frikën se do të zgjohej, por dukej mirë. Pastaj hodhi sytë në të majtë. Ilda lëvizi pak, por nuk u zgjua. Ai ngriu i tëri kallëp.

“O Zot, sa e bukur!”, e ngacmonin mendimet. “Ç’buzë, ç’gushë...” Sytë tashmë ia komandonte instinkti mashkullor. Gjoksi po i dihatej rëndë nga frymëmarrja e shpeshtë, teksa kulloste sytë mbi trupin peri të Ildës, e cila nuk kishte hedhur mbulesë mbi vete dhe linte që fustani t’ia tregonte gjithë format e përsosura. Gjoksi, vithet, këmbët e ai parfumi që shpërndahej në hapësirë kudo që ndodhej ajo, po e bënin Arturin të çmendej nga dëshira...

Mblodhi veten nga këto mendime dhe bëri të ikte.

- Profesor? - u tremb Ilda që lëvizi përgjumësh dhe dalloj siluetën e burrit.

- Shshst... - ia bëri me gisht ai dhe doli i pari në majë të gishtave, për të mos zgjuar Rinën. Pas tij u ngrit Ilda me të shpejtë e shkoi e kërkoi falje që e kish zënë gjumi në shtratin e tij.

- Mos e përmend më! - e qetësoi Arturi. - Mirë bërë që u çlodhe. Ndoshta kjo do të të ndihmojë, pasi mund të rrih pak më shumë sot, se do të vonohet Lida. A e ke problem?! - pyeti ai.

- Jo, për lodhje s’dua t’ia di, - i tha Ilda. - Por puna është se fugoni i fundit niset në 5 e 30 dhe nuk kam me ç’të kthehem.

- Mund të të çoj unë!

- Dakord...

- Po Rina ngase ta kishte atë temperaturë?

- Ç't'ju them profesor?! Pasi iku zonja, duke e puthur, buzët më ndjenë të nxehtin e faqkave të saj, pastaj si ju thashë...

“Ah, ato buzët e tua!”, mendoi ai dhe e pa Ildën ngultas në sy. Ajo iu shmang vështrimin e iu drejtua banakut të kuzhinës.

“Të ketë kuptuar gjë vallë?”, i sorollateshin sërish në kokë qindra mendime të mbrapshta. Thonë që gratë dinë t'i lexojnë shumë mirë shikimet e burrave. Më mbro o Zot, më shpëto nga tundimi. Nuk është e drejtë!

- Bëra pak pazar, - tha me zë të ulët, - por nuk i vura dot në vend, se sikur e ndjeva që ishit duke fjetur dhe s'desha të bëja zhurmë. Po të ndihmoj dhe unë.

- S'ka gjë profesor, i vendos vetë.

- O Ilda, mos më thuaj profesor, të lutem!

- Më është mësuar goja profesor, - tha sërish ajo dhe i fali atij një buzëqeshje, duke e parë në sy.

Dhoma shndriti nga mijëra vezullima dritash dhe ai shikim magjiplotë ia turbulloi mendjen profesorit.

“I ziu unë, ç'të bëj?! Ku të zhdukem!”, i gëlonin mendimet përbrenda. S'kishte faj, baruti dhe zjarri nuk duhet të rrinin në një vend bashkë.

- Mirë, mirë, më thirr si të ndihesh më rehat dhe ti vetë. Por, më thuaj, a gatujmë diçka për sot? - e pyeti duke dashur të ndryshonte rrjedhën e bisedës.

- Ja, sa t'i vendos këto nëpër vende, - iu përgjigj e gatshme Ilda, duke i treguar qeset e marketit. Ai u